



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

81 Nr. / Br. 80/20

Nr. i fq. / Br. sht. - 13 -

Data: / Datumi 28. 05. 2020

VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 23 PRILL 2020**

*Mbledhja është mbajtur në objektin e Shkollës së Mesme Gjimnazi "Eqrem Çabej" në Vushtrri, duke filluar në orën 14:20.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrris: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Habibe Gërzhaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Miljan Bojković, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova Safet Idrizi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Sylja Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Ali Januzi, Gentiana Rama, Hysni Gërguri, dhe Fitim Halili,

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit-** pasi hapi mbledhjen tha se uroj që të tejkalohet kriza nga pandemia që e ka përfshirë globin në tërësi. Tutej prezanto se në pikën në të ndryshme janë proceduar edhe katër pika tjera të cilat kanë të bëjnë me ndarjen e subvencioneve. Ai i propozoi kuvendit që tri (3) pikat shtesë që janë në të ndryshme të fuzionohen në pikën e gjashtë të rendit të ditës pasi janë të të njëjtës natyrë. Tutje ai duke ju referuar Udhëzimit Administrativ të MAPL-së për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit njoftoi se ky akt e përjashton mundësinë e ndryshimit dhe plotësimit të rendit të ditës në mbledhjet e jashtëzakonshme. Por ai vlerësoi se neni 44 paragrafi 3 i LVL-së përcakton se pikat e rendit të ditës nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**të nderuar deputet, i nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar e ju të pranishëm. Fillimisht dëshiroj ti falënderoj të gjitha bizneset, njerëzit e vullnetit të mire, diasporën dhe të gjithë donatorët që kanë ndihmuar dhe po ndihmojnë në tejkalimin e kësaj pandemie.

Gjendja aktuale me pandemi covid-19 ka prekur e dërmuar secilin qytetar të komunës sonë, secilin biznes e më së shumti ka goditur të pa punët, rastet sociale dhe atë pa kurrfarë të ardhurash personale e familjare. Ky është një pasqyrim i gjendjes së rënd ekonomike, sociale dhe financiare të qytetarëve tanë. Përkundër faktit që qeveria komunale pati marr disa iniciativa të cilat ne jo vetëm se i kemi përkrahur po edhe ju kemi dhanë fuqi dhe nga propozimi i qeveris 100 mijë euro kemi propozuar dhe kemi rritur vlerën në 200 mijë euro me qëllimin e vetme që të tejkalohet kjo situatë në mënyrën më të mirë të mundur efektet janë përmbushur pjesërisht dhe kemi një mjegull sa i përket ofrimit të ndihmave. Shtabi komunal anti covid-19 ishte formuar me qëllimin e luftimit të kësaj pandemie dhe ofrimit të ndihmës për të gjithë qytetarët e komunës pa dallim përkatësie fetare, partiake a te tjera dallime dhe në seancën e kaluar pata propozuar që në këtë shtab të plotësohet së paku edhe me dy anëtar të kuvendit kjo do të kontribonte në dy relacione e para në ofrimit të ideve kreative dhe profesionale për veprimet e shtabit dhe e dyta transparencën e punës dhe veprimeve sidomos në këtë kohë kur edhe procedurat e prokurimit mund të përdoren ato të negociuara, përkundër propozimit tim dhe zotimit të kryetarit se do të perfaqesohet edhe opozita në shtabin emergjent nga partia më e madhe kuvendare kjo nuk u realizua andaj kemi dyshimet tona se ka prapaskena të pajustificueshme për ne. Lidhur me këtë elaboroj se Komuna e Skenderajt ka marrë vendim dhe ka përzgjedhur tre deputet në komisionin për pjesëmarrje në vlerësimin e procedurave të negociuara të prokurimit krejt kjo me qëllim të ruajtjes së buxhetit, llogaridhënës, transparencës dhe parandalimit të korrupsionit. Ne dhe qytetarët e Komunës së Vushtrris nuk jemi të kënaqur me punën e kësaj qeverie dhe as të shtabit qeveritar të formuar sepse ky shtab dhe kjo qeveri vetëm në facebook dhe blloqe marketingu kanë plasur spote të ndryshme të cilat në shumë raste janë për keqardhje dhe manifestojnë garë politike. Shumë pak apo fare nuk janë trajtuar rastet e skamnorëve ato sociale e edhe ato familje që janë prekur direkt dhe janë mbajtur e mbahen në karantinë. Andaj publikisht kërkoj që të bëhen transparente të gjitha donacionet, vlera e tyre, përmbajtja, donatori si dhe të gjitha ndihmat që janë ndarë nga komuna gjithashtu edhe përfituesit me emër mbiemër dhe adres banimi.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-pasi falënderoi anëtarët e kuvendit të cilët i janë përgjigjur pozitivisht ftesës për mbledhje të jashtëzakonshme, në të cilën do të merren një sërë masash ekonomike për përbalimin e situatës me pandeminë Covid-19. Pastaj ai paraqiti statistika lidhur me numrin e testeve për pacientë eventual me covid-19 ku ceku se deri me tanë janë kryer 153 teste nga to 24 kanë rezultuar pozitiv, dhe fatkeqësisht kemi një qytetare nga fshati Smrekonicë e cila ka ndërruar jetë, ndërsa 7 qytetarë janë shëruar, në pesë ditët e fundit nuk kemi pasur asnjë rast pozitiv me covid-19. Masat e marra nga shtabi emergjent komunale në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë sipas rekomandimeve të IKSHPK-së, kanë bërë që në këtë punë të jemi të suksesshëm. Është arritur që të shuhet vatra në fshatin Studime pa pasoja njerëzore, është parandaluar shpërthimi i virusit nga një market i njohur në qytetin tonë duke ruajtur qytetarët dhe biznesin në fjalë ashtu që punëtorja e këtij marketit në fjalë është shëruar plotësisht. Një rast tjetër është në fshatin Samadrexhë por fal stafit mjekësor në ambulancë ky rast është menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këtë rast pasi nuk është konstatuar gjendja Ministria e Shëndetësisë e ka shpallur fshatin Samadrexhë burim të infeksionit. Fshati Smrekonicë i cili është i karantinuar virusi është lokalizuar vetëm në dy familje dhe kjo është mirë pasi që virusi nuk po shpërndahet më tej. Ai ceku se si pasoj e pandemisë janë paraqitur rreth 1500 familje jashtë asistencës sociale që kanë kërkuar ndihmë dhe komuna ju ka dal në ndihmë me pako ushqimore dhe higjienike. Pastaj ai ceku se nuk është koha për të bërë politikë pasi që gjendemi në situatën e pandemisë dhe shtoi se Komuna e Vushtrrisë është e dyta në nivel vendi me numrin më të madh të kërkuesve të asistencës sociale dhe kjo është bërë si rezultat i qeverisjes së keqe nga e kaluara.

Lidhur me përfshirjen e opozitës në shtabin emergjent komunale, njoftoi se rekomandimi nga mbledhja e fundit ka qenë që pjesë e këtij shtabi të jetë Dr. Safet Idrizi nga radhët e PDK-së, por ky i fundit nuk ka ardhur në mbledhje si rezultat i presionit të partisë së tij dhe i njëjti është dorëhequr nga shtabi, andaj vlerësoi se shtabi ka pasur nevojë për njerëz profesionit e jo për përfaqësim politikë. Lidhur me prokurimin ceku se ligji i prokurimit është funksional dhe aktiviteti zhvillohet në saj të tij përjashtimisht bëhet tërheqja nga procedurat e tenderimit për rastet që kanë të bëjnë me pandeminë për zhvillim të procedurave të negocimi por vetëm pas marrjes së aprovimit nga ana e KRPP-së. Sa i përket ofrimit të ndihmave u zotua se lista e përfituesve dhe donatorëve do të jetë publike dhe plotësisht transparente për të gjithë. Në vazhdimi i dha sqarime lidhur me pikat e agjendës së mbledhjes ku shtoj se vendimet që do të merren në këtë mbledhje plenare kanë ndikim direkt në buxhetin e komunës dhe kjo po bëhet për lehtësimin e procesit të menaxhimit të pandemisë covid-19 dhe lehtësimin e jetesës së qytetarëve. Gjithashtu po inicohet procedura e hartimit për themelimin e një trupi për bërjen e një analize lidhur me ndikimin e pandemisë në fushën ekonomike dhe masat për rimëkëmbjen e saj.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se zotimi i kryetarit ka qenë që opozita të jetë e përfaqësuar në shtabin emergjent, dhe kryetari i komunës ka menduar se ai mund ta menaxhoj grupin kuvendar të PDK-së duke kërkuar emra se cilët duhet të jenë personat e përshtatshëm dhe të dëgjueshëm të përfaqësuar në shtab. Pastaj njoftoi se Safet Idrizi është tërhequr pa presionin e askujt, ndërsa i deleguar nga grupi kuvendar ka qenë ai vetë por si duket kjo i ka penguar kryetarit të komunës. Ai në fund vlerësoi se kryetarit të komunës nuk i beson as partia e tij dhe nuk e ka luksin që as brenda LDK-së të përzgjedh persona e lëre më në subjektet tjera. Ai u zotua që do ta luajnë rolin opozitar siç ju takon në saj të ligjit për të qenë në krye të detyrës.

**Nezir Klinaku, anëtarë i kuvendit**-tha se kryetari i komunës apelon që mos të bëjmë politikë në gjendje pandemie, ndërsa ai mbanë fjalime politike para kuvendit mendje referim puro politikë duke përdor obstrukcion politikë. Pastaj ai e përgëzoi drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë për informimin e drejtë dhe korrekt të opinionit publik lidhur me gjendje e pandemisë në komunën tonë. Lidhur me mbajtën e mbledhjes pyeti kryesuesin e kuvendit se a ka opinion ligjor me shkrimi i cili konstaton se mund të ndryshohet rendi i ditë në mbledhjet e jashtëzakonshme. Në rastin konkret në emër të LB-së deklaroi se nuk do të votoj rendin e ditës duke e ditur se po shkelet ligji. **Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit**-në referim të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale neni 44 ceket se pikat e rendit të ditës nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhje dhe ne akoma nuk kemi një rend të ditës të aprovuar.

**Hajriz Mustafa, anëtarë i kuvendit**-pasi shprehur ngushëllime familjes Hasani nga fshati Smrekonicë për humbjen e anëtarit të familjes nga corona-virusi, ceku më tej se përgëzon komunën për punët e mira që janë bërë në menaxhimin e kësaj pandemi dhe sidomos ndihmën e ofruar për fshatin Smrekonicë. Mirëpo në fshatin Smrekonicë kemi vonesa në shpërndarjen e ndihmave ushqimore dhe breng tjetër është se pas karantinës së këtij fshati shumë punëtor në sektorin privat do të mbesin pa punë. Ai shprehu keqardhje për publikimin e emrit të hoxhës së fshatit i cili ka qenë i infektuar me covid-19. Propozoi që të ketë një minutë heshtej për viktimën në fshatin Smrekonicë.

*Në vazhdim kuvendi mbajti një minutë heshtej në nderim të viktimës nga fshati Smrekonicë si pasoj e corona-virusit covid-19.*

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-pasi uroj që kjo mbledhje e kuvendit të jetë e fundit që po mbahet në këto rrethana dhe që të gjithë qytetarët ti kthehen normalitetit të tyre, shtoi se ajo e përgëzon



Komunën e Vushtrrisë për menaxhimin e efikas të situatës nga pandemia duke pasur parasysh numrin e madh të të prekurve me këtë virus në komunën tonë dhe kjo si në aspektin informimit ashtu edhe në aspektin e furnizimit me pako ushqimore. Pastaj ajo përgëzoi Qeverinë e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mirë të pandemisë dhe shtoi se një shembull i tillë duhet të ndiçet edhe nga komuna jonë e cila duhet të themeloj një ekip komunal i cili do të informonte qytetarët për aplikimin lidhur me pakon emergjentet pasi si dhe të kemi një numër telefoni në dispozicion ku qytetarët do të mund ti adresonin problemet e tyre në këtë relacion.

**Lorik Maxhuni anëtarë i kuvendit**-pasi falënderoi qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për respektimin e vendimeve dhe masave të qeverisë qendrore dhe lokale në këtë kohë pandemie. Ai vlerësoi se dora e Partisë Demokratike të Kosovës i është shtrirë institucioneve për ti ofruar ndihmë dhe nëse këtë dikush nuk e sheh atëherë i bie se ai është verbuar. Tutej shtoi se edhe përfaqësuesit në kuvend që vinë nga fshati Smrekonicë konstatuan se në këtë fshatë ka pasur dështim në menaxhimin e situatës në këtë fshatë. Prandaj tani të del dikush e të deklaron se po bëhet politikë duhet ta dinë se kuvendi para së gjithash është një organ politikë por se ai është shndërruar në një trup administrativ i qeverisë së komunës. Kjo qeveri ka arritur të organizoj koncert në sheshin e qyteti, ndërsa banorët e fshatit Smrekonicë bënin thirrje për pako ushqimore dhe kjo është fakt i pamohueshëm. Në fshatin Smrekonicë nuk ka pasur ekiye shëndetësore dhe ato kanë shkuar pas kërkesës së vazhdueshme të kryetarit të fshatit z.Fidan Bejta, i cili në rrejtët sociale ka deklaruar se ka pasur kërcënime për padi nga zyrtarët e komunës. Në komunën tonë ka qenë një vatër me corona virus dhe aty ka ndodhur keq menaxhimi, mandej ka pasur edhe favore biznesore ekonomike duke favorizuar një kompani farmaceutike duke u thyer kështu rregullat e konkurrencës. Partia Demokratike e Kosovës e ka shtrirë dorën e bashkëpunimit dhe këtë e ka bërë kur ka propozuar që të rritet fondi për menaxhimin e corona-virusit. Në fund tha se partia të cilën ai e përfaqëson është plotësisht e lirë dhe ajo vendos vetë me strukturat e saj se kush do ta përfaqësojë, andaj nuk mund kryetari i komunës që të përcaktoj se kush do ta përfaqësojë atë, madje ai nuk ka tagër të flasë as në emër të LDK-së, pasi që atij nuk i beson askush.

**Safet Idrizi, anëtarë i kuvendit**-tha se situata me pandeminë covid-19 e cila e ka përfshirë globin në tërësi, e në këtë rast edhe vendin e komunën tonë, ka bërë që të gjithë për bashkohemi për të bërë më të mirën e mundshme. Në Komunën e Vushtrrisë janë bërë 153 teste për covid-19, 24 prej tyre kanë rezultuar pozitive ndërsa një (1) ka përfunduar me fatalitet. Duke marrë për bazë gjendjen e një rreziku të madhe e të padukshëm ku pasojat mund të jenë të rënda ftoj të gjithë për solidaritet, bashkëpunim duke i lënë anash dallimet e subjekteve politike por të punohet bashkërisht për tejkalimin e kësaj gjendje. Pasi që nuk dihet akoma se a është piku i pandemisë, ftoj qytetarët që respektojnë masat në përdorimin e maskave, dorëzave dhe duke mbajtur distancën sociale. Në fund tha lirim i masave kufizuese duhet të bëhet në mënyrë graduale duke mos rrezikuar përhapjen dhe kthimin e këtij virusi.

**Ymer Haradinaj, anëtarë i kuvendit**-pasi falënderoi komunën dhe shtabin emergjent për menaxhimin e situatës së pandemisë, propozoi që krahas shtabit emergjent komunal të formohen edhe nënë shtabet nëpër fshatrat të cilat i udhëheq kryetari i këshillit të fshatit, kurse në ato nënë shtabe do të mund të merrnin pjesë edhe drejtorët e shkollave imamët e fshatrave njerëz me autoritet, mjek në mënyrë që të lehtësohet puna e shtabit emergjent komunalë. Themelimi i këtyre trupave do të ndihmonte edhe në përshpejtimin e shpërndarjes së pakove ushqimore.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-sqaroi se pakot ushqimore nuk i shpërndan shtabi emergjent, por me vendimi është themeluar një komision në përbërjen e të cilit bënë pjesë Qendra për Punën Sociale, Bashkësia Islame, Kryqi i Kuq, KVRL dhe organizma tjerë. Këto ndihma janë shpërndanë në bazë të listës nga QPS-ja dhe i është dhënë prioritet familjeve që nuk janë përfituese të ndihmave

sociale pasi që familjet me asistencë sociale kanë përfituar nga dy ndihma në të njëjtën kohë, andaj me këtë çështje nuk është marr shtabi emergjent me qëllim që ky proces të jetë plotësisht transparent dhe pa ndikim nga brenda. Deri në këto momente kanë përfituar rreth 1200 familje që nuk i nënshtrohen skemës sociale, ndërsa nga nesër do të filloj shpërndaj e pakove për familjet që janë përfituese të asistencës sociale sipas listës së QPS-së. Për shpërndarjen e pakove ushqimore janë konsultuar edhe këshillat dhe kryetarët e fshatrave të cilat funksionojnë si nënë shtabe. Në lidhje me shpërthimin e virusit në fshatin Smrekonicë, njoftoi se ka mbajtur lidhje të vazhdueshme me kryetarin dhe komunitetin e këtij fshati. Ka pasur kërkesa për të dërguar barna falas në këtë fshat por kjo ka qenë e pamundur pasi që kërkesat janë të mëdha dhe aty shtohen kërkesat edhe për lokalitetet tjera dhe këtë nuk e përballon buxheti i komunës. Tutej shtoi se duke marrë për bazë mjetet financiare në dispozicion të komunës, kapacitetit e komunës dhe duke ja shtuar kësaj edhe klimën politike në kuvend mendon se është bërë më e mira e mundshme në menaxhimin e situatës së pandemisë. Ai përsërit se komuna dhe shtabi emergjent e ka menaxhuar situatën e pandemisë në mënyrë të shkëlqyeshme dhe shtoi se nuk pret që të ketë lëvdata nga kundërshtarët politikë, por megjithatë e habitë fakti se si mund të ketë xhelozë dhe urrejtje kaq të madhe ndaj ti nga oponentët politikë. Në fund ai bëri thirrje për ndaljen e kësaj gjuhe denigruese dhe fyese që nxitë urrejtje, e cila kohëve të fundit ka kulmuar me kërcënim me eliminim fizik ndaj tij.

**Ilmi Azemi, anëtarë i kuvendit**-tha se ndaj askujt e as ndaj kryetarit të komunës nuk asgjë personale, dhe shtoi se dallimet politike partiake e konceptuale, ashtu siç po mundohet tu jep kaheje kryetari i komunës është e padrejtë dhe e papranueshme. Pastaj shtoi se tendenca për tu viktimizuar dhe për të dal mirë para të tjerëve e kryetarit të komunës nuk është etike dhe ajo tek ai dhe PDK nuk shkon, për faktin se kryetari i komunës po tenton që në këtë formë të mbuloj keq menaxhimin e tij dhe të qeverisë së tij për të cilat ai dhe grupi kuvendar i PDK-së nuk do të pajtohen asnjëherë.

**Nezir Klinaku, anëtarë i kuvendit**-tha se ai personalisht as ndaj kryetari të komunës e as ndaj askujt tjetër nuk ka urrejtje, sepse po të kishte do ta shprehet lirshëm sipas stilit të tij dhe vlerësoi se kryetari i komunës po manipulon dhe kur këtë ja thonë kjo i dhembë. E vërteta është se që nga fillimi fjalimi i tij u karakterizua me akuza të rreme për shtimin e rasteve sociale që është bërë nga qeveria e kaluar, pastaj shtoi se ata po ndihmohen nga qeveria qendrore dhe në fund tregon se ka edhe raste të reja dhe kjo dëfton për jo konsistencë në deklaratimet e tij dhe tendencën për mashtrimin e opinionit.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-tha se i vjen shumë keq që në këto kushte të jashtëzakonshme kemi zgjatej kaq të madhe të debateve shterpe me akuza e kundër akuza të cilat nuk qojnë askund fare. Ajo propozoi që ti kthehemi rendit të ditës dhe edhe një here apostrofoi që në numrin e komunë që është pa pagesë në shërbime të qytetarëve të angazhohet ndonjë zyrtarë komunale i cili do të kontaktonte me qytetarët dhe do ti udhëzonte ata për aplikim për pakon emergjente në Ministrinë e Financave.

**Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit**-tha se duke marr për bazë rrethanat dhe kushtet e jashtëzakonshme dhe rëndësinë e këtyre vendimeve që prekin interesin vital të qytetarëve apeloj tek anëtarët e kuvendit që ta aprovojnë rendin e ditës dhe propozoi që në pikën në të ndryshme që lidhet me shpërndarjen e subvencioneve të fuzionohen 3 pikat shtesë të proceduar në pikën në të ndryshme dhe atë: Propozim-vendimi për ndarjen e subvencioneve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, Propozim-vendimi për ndarjen e subvencioneve në Drejtorinë e Arsimit, Propozim-vendimi për ndarjen e subvencioneve në Zyrën e Kryetarit këto 4 pika të shqyrtohen dhe aprovohen si një pikë e veçantë.

*Në fund të diskutimeve jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 30 vota "për" 1 votë "abstenim" nga anëtari i kuvendit z.Nezir Klinaku, aprovoi këtë:*

## REND DITE

1. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020;
2. Shqyrtimi i raportit për të hyrat dhe shpenzimet komunale janar-mars 2020.
3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për inicim të studimit mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në ekonominë lokale formale e jo formale të Vushtrrisë dhe masat për rimëkëmbjen ekonomike pas kësaj pandemie;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzimin e hapësirave publike në qytet;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirim nga pagesa e tarifave në institucionin për edukim dhe arsimim parashkollor publik në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarje të mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2020;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit të pagesës së këstit për lejet ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë;
8. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020;

**Ilmi Azemi, anëtarë i kuvendit**-pyeti se përse është e nevojshme të kemi bartej të mjeteve financiare nga kategoria e pagave dhe mëditjeve në vlerën prej 66,466.59 €, kur dihet fakti se në vitin e kaluar kemi rreth 350,000.00 € të cilat kanë shkuar në suficit dhe se numri i punëtorëve është i njëjti në Komunën e Vushtrrisë punëtorët që janë me kontrata fike nuk paguhen nga kjo kategori. Tutej shtoj se nëse edhe këtë vit nuk kemi procedura për rekrutim të stafi do të kemi rritej të fondit nga kjo kategori dhe që këto mjete do shkojnë në suficit dhe ky fond për dy vitet e ardhshme do të jetë rreth 1,000.000 € dhe kjo nuk mund të kualifikohet ndryshe përpos si keqmenaxhim i parasë publike. Mos futja e këtyre mjeteve financiare në qarkullim ekonomik përpos që është papërgjegjësi totale ajo e dëmton rënd edhe ekonominë e komunës.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-sqaroi** se bartja e mjeteve financiare nga kategoria e pagave, është bërë duke u marrë për bazë se këtë vit është menduar që të hynë në fuqi ligji i pagave.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe mëditje .....	66,466.59 €
1.2 Mallra dhe shërbime .....	368,758.46 €
1.3 Shpenzimet komunale.....	17,379.90 €
1.4 Subvencionet dhe transferet.....	50.00 €
1.5 Investime kapitale .....	903,608.38 €

Totali i mjeteve të bartura .....1,356,263.33 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale, si dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

2. Shqyrtimi i raportit për të hyrat dhe shpenzimet komunale janar-mars 2020;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota “unanime” aprovoi raportin për të hyrat dhe shpenzimet komunale janar-mars 2020.*

3. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për inicim të studimit mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në ekonominë lokale formale e jo formale të Vushtrrisë dhe masat për rimëkëmbjen ekonomike pas kësaj pandemie;

**Ilmi Azemi, anëtarë i kuvendit**-tha se ky propozim-vendim ka dy prerogativa kryesore e para ka qëllim sipërfaqësor të mirë e dyta ka qëllim të keq. Kjo është kështu për faktin se qëllimi është i mirë në vetveten e tij sepse shtrohet nevoja që të bëhet një analizë për gjendjen e ekonomisë së komunës pas pandemisë, dhe qëllimi i tij i keq është sepse pika e dytë e këtij vendimi është se kuvendit me vota ta autorizoj ti japi mandatin kryetarit të komunës që të ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme ekonomike dhe të rimëkëmbjes sikur të ishte në sistemin ky qeverisë monarku. Në këtë rast propozoi që në pikën 2 të këtij vendimi të kemi riformulimin e nenit si në vijim: të themelohet një komision në përbërje 5 anëtarë nga kuvendi i komunës dhe 2 anëtarë nga qeveria komunale, në mënyrë që të fillojmë me punë profesionale përgatitore dhe ta përcjellim implementimin e këtij studimi. Andaj ai shtoi se nuk është i pajtimi që kryetari i komunës të autorizohet blanko për ti ndër marr këto veprime pasi që i njëjti nuk është transparentë dhe i cili nuk ka pranuar bashkëpunim e ofruar nga PDK, por edhe në këtë kohë të pandemisë ka manipuluar, nuk ka pranuar që të jetë pjesë e shtabit emergjentë përfaqësuesi i PDK-së edhe përkundër zotimeve të bëra para kuvendit, ai nuk beson në këtë dhe ka frik se do të manipulohen mjetet nëse shkohet në formë siç është propozuar nga qeveria komunale. Në fund ai kërkoi nga kryesuesi i kuvendit që kjo pikë të hudhet në votim sipas propozimit të tij dhe më pas konform kësaj të propozohen emrat e komisionit nga grupet kuvendare.

**Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit**-s qaroi se me këtë propozim vetëm po merret iniciativa profesionale për një studim fizibiliteti profesionale dhe pastaj që ai raport i studimit të silltet në kuvend për aprovim.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se qëllimi i këtij propozim është që të kemi një studim të thellë mbi impaktin e covid-19 në ekonominë e komunës, dhe pastaj masat të cilat do të propozohen nga profesionistët do të sillen në kuvend për diskutim dhe aprovim final. Po ashtu ai përsërit se pas përfundimit të pandemisë do të ketë masa për rimëkëmbje ekonomike përmes pakove stimuluese ekonomike qoftë nga Qeveria e Kosovës apo nga mekanizmat financiar ndërkombëtarë dhe për këto komuna duhet të jetë e përgatitur për të pasur një udhërrëfyes të



segmenteve në të cilët duhet të intervenojë. Një studim i tillë do të mund të përgatitet deri kah muaji nëntor i këtij vit dhe koston e këtij projekti do ta mbulojë Qeveria e Kosovës nga fondi për luftimin e pandemisë covid-19. Ai ftoj për unitet dhe bashkëpunim të gjithëve pasi kjo gjendje e pandemisë do të zgjatë edhe për një kohë jo të shkurtër dhe kjo do të lë gjurmë dhe do ta afektoj edhe buxhetin e komunës, dhe e cila do të ndikoj direkt në rënie ekonomike. Lidhur me atë se atij nuk i beson askush ai ceku se atij nuk i beson PDK-ja sepse është parti e ndryshme nga paria e tij, dhe shtoi se ai është zgjedhur nga qytetarët e Komunës së Vushtrrisë dhe ata i kanë besuar kur e kanë votuar, andaj në këtë rast ia i përgjigjet qytetarëve të komunës e jo PDK-së.

**Agim Bregaj, anëtarë i kuvendit**-e përgëzoi qeverinë dhe shtabin komunale emergjent për menaxhimin e mirë të situatës nga pandemia covid-19 duke përkrahur masat që janë ndërmarr e po ndërmerren për heqjen e taksave dhe lehtësirave tjera për qytetarët dhe bizneset. Ai shprehu nevojën që të kemi një kontratë të përgjithshme sociale ku pjesëmarrës do të jetë qeveria, shteti dhe komuna që të dilet me një platformë për tejkalimin dhe lehtësimin e obligimeve financiare të qytetarëve tanë.

**Ilmi Azemi, anëtarë i kuvendit**-tha se pas sqarimit të bërë nga kryetari i komunës si grup kuvendar do ta votojnë këtë propozim-vendim, por shtoi se nuk është korrektet nga ana e kryetarit që në njërën anë të kërkoj unitet e në anë tjetër të sulmoj e akuzoj grupin kuvendar të PDK-së.

**Nezir Klinaku, anëtarë i kuvendit**-tha se hartuesi i këtij propozim-vendimi duhet të dal dhe të jep sqarime lidhur me këtë akt se cili është qëllimi dhe synimi që komuna dëshiron të arrijë me këtë studim fizibiliteti.

**Miran Halili, drejtor i DEBPZHR-së**-sqaroi se me këtë propozim-vendim është marrë me qëllim të inicimit të procedurës për hartimin e një ekspertize apo studimi për ndikimin e covid-19 në ekonominë e komunës.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim, inicohet procedura për studim mbi ndikimin e virusit Covid-19 në ekonominë lokale, formale e jo formale të Komunës së Vushtrrisë dhe masat për rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë së virusit Covid -19.
2. Autorizohet Kryetari i Komunës që të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për rimëkëmbjen ekonomike të Komunës së Vushtrrisë.
3. Raporti i studimit për ndikimin e pandemisë Covid-19 në ekonominë e komunës duhet të dërgohet në kuvend për aprovim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzimin e hapësirave publike në qytet;



**Bahrije Ademi-Murati, anëtare e kuvendit**- siç po e shohim , infeksioni covid 19, përveç që po e rrezikon shëndetin e qytetarëve, me theks të veçantë të moshuarit të cilët kanë edhe problem të tjera shëndetësore , sidomos ata me sëmundje kronike, po i rëndon edhe ekonomitë familjare, dhe të gjitha bizneset në Kosovë pa përjashtim, e edhe ato të komunës së Vushtrrisë. Duke e pa situatën me të cilën po përballen edhe bizneset, edhe ekonomitë familjare, mendojmë që është shumë e rëndësishme që ne si komunë, dhe si kuvend komunal, t'iu dalim në ndihmë me aq sa mundemi dhe me aq sa kemi kapacitete, që kjo gjendje të kalojë me sa më pak pasoja. Jemi të vetëdijshëm që buxheti i komunës sonë është shumë i vogël, për shkak të trajtimit selektiv nga qeverisjet e kaluara në ndarjet buxhetore për komunën tonë, megjithatë, kjo nuk duhet të na pengojë që ne t'i përkrahim ekonomitë familjare të Vushtrrisë, dhe bizneset që operojnë në komunën tonë. Prandaj, ne si Grup Kuvendar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, e përkrahim propozimin që të lirohen nga pagesa të gjitha bizneset që i paguajnë qira komunës sonë për shfrytëzimin e hapësirave publike, deri me 31. dhjetor 2020, në ndërkohë propozojmë që; të lirohen nga pagesa e mbeturinave të gjitha ekonomitë familjare që janë në asistencë sociale nga muaji prill deri me 31 dhjetor 2020 , pagesën e së cilës propozojmë që ta marrë përsipër komuna. Besojmë që këto lehtësira, sado pak do t'iu ndihmojnë qytetarëve dhe bizneseve për tejkalimin e kësaj sate me të cilën po përballemi të gjithë, prej së cilës nuk jemi imun asnjë nga ne. Besojmë në mirëkuptimin e grupeve të tjera kuvendare, prej të cilave në të njëjtën kohë presim përkrahje në propozimin tonë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtarë i kuvendit**-propozoi që përveç hapësirave publike që janë dhënë në shfrytëzim në qytet të lirohen nga pagesa e qirasë edhe hapësirat apo pronat e dhëna në shfrytëzim për bujqit e Komunës së Vushtrrisë.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi** se me këtë propozim-vendim lirohen nga pagesa e qirasë bujqit të cilët kanë marrë pronë në shfrytëzim nga komuna, por edhe shfrytëzuesit e hapësirave publike në qytet.

**Nezir Klinaku, anëtarë i kuvendit**-propozoi që në vendim të ceket jepja e pronave në shfrytëzim në Komunën e Vushtrrisë, përmirësimi të bëhet aty ku thuhet qytet të bëhet në Komunën e Vushtrrisë.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës**-tha se pasi që propozimi i znj. Bahrije Ademi nuk mundet proceduralisht të futet në rend të ditës atëherë kërkoi që ky propozim të futet në rend të ditës në mbledhjen e radhës.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se nëse vendosim që taksa për shërbimet e mbeturinave për familjet me asistencë sociale të hiqet për tre muaj atëherë askush nuk na siguron se pandemia kalon në fund të muajit maj, andaj kjo çështje duhet të analizohet mirë pas ka një kosto financiare dhe nëse kjo bëhet atëherë kjo duhet të bëhet me një vendim të veçantë për krejt vitin 2020 në mbledhjen e radhës.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim dhe hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë.**

**2. Lirimi nga pagesat e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë do të zgjasë nga data 1 mars deri më 31 dhjetor 2020.**

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të mjedisit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirim nga pagesa e tarifave në institucionin për edukim dhe arsimim parashkollor publik në Komunën e Vushtrrisë;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim, lirohen nga pagesa e tarifës komunale për prindërit e Komunës së Vushtrrisë për shërbimet e edukimit për fëmijët e tyre të cilat ofrohen në Çerdhen e Fëmijëve “Foleja” në Vushtri.

2. Lirimi nga pagesa sipas pikës paraprake të këtij vendimi do të bëhet prej datës 01.03.2020 deri në fillim të vitit të ri shkollor 2020-2021.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarje të mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2020;

**Ilmi Azemi, anëtarë i kuvendit**-paraqiti vërejtjet e tij tek pika 1.1.2 e propozim-vendimit për subvencione tek Drejtoria e Kulturës sa i përket financimit të OJQ-ve ku do të duhej të sqarohet se kemi të bëjmë me klube sportive. Ai e përkrahi në terisë këtë propozim –vendim dhe kërkoj që të shikohet mundësia që klubet sportive të ndihmohen sërish.

**Ymer Haradinaj, anëtarë i kuvendit**-propozoi që në propozim-vendimin e Drejtorisë së Arsimit konkretisht pika 1.3 bursa për nxënës të futet edhe profili saldues dhe përpunimi i drurit edhe në SH.M.P “Bahri Haxha” që edhe këta nxënës të klasës XI të përfitojnë bursë dhe mos të kemi ndarje dhe diskriminim.

**Nezir Klinaku, anëtarë i kuvendit**-pyeti kryetarin e komunës se përse propozim-vendimit për ndarjen e subvencioneve nuk kanë arsyetime.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se vitin e kaluar Komuna e Vushtrrisë si njëra nga komunat e vetme ka publikuar të gjitha vendimet e që kanë të bëjnë me përfitim të subvencioneve listën e subvencioneve e ka bërë transparente. Andaj edhe në këtë vite do të veprohet njëjtte që lista do jetë transparente dhe do të dihen emrat a atyre që kanë përfituar.

**Fatmire Cecelia, drejtoreshë e DKRS-së**-paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin ku ceku se të gjitha klubet sportive e kanë statusin juridik të OJQ-ve.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-njoftoi se subvencionet janë kryesisht nga të hyrat vetanake, dhe nëse nuk kemi të hyra vetnake si komunë këto vendime do të jetë vështirë të zbatohen pasi trendi i të hyrave është i ulët.

**Afrim Namani, drejtor i DKA-së**-tha se sa i përket propozimit që edhe nxënësit e SH.M.P “Bahri Haxha” të subvencionohen jemi në një udhëkryq pasi që këta nxënës do të subvencionohen në saje të një rregulloreje për bursat për student, dhe shpërblimet për nxënës e cila ka qenë në procedurë që të vij në kuvend në muajin mars por që ishte ndërprerë për shkak të pandemisë. Andaj pas aprovimit të kësaj rregulloreje edhe këta nxënës do të subvencionohen.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-njoftoi se Komuna e Vushtrisë është komuna e parë në Kosovë e cila ndan bursa për nxënësit e shkollës teknike krejt kjo me qëllim të ngritjes së nivelit të profileve teknike të mësimi. Pasi që komuna jonë ka të zhvilluar sektorin e zdrucktarisë dhe industrisë së drurit si komunë do ti japim prioritet profileve shkollore të përpunimit të drurit në shkollat teknike dhe profesionale.

**Ymer Haradinaj, anëtarë i kuvendit**-kërkoj sqarime lidhur me atë se sa nxënës janë në ato dy profile që do të përfitojnë burës në shkollën teknike, dhe kërkoi që propozimi i tij të hidhet në votim që në përfitim të bursës të futen edhe nxënësit e SH.M.P “Bahri Haxha”, klasa e XI profili përpunuese i drurit.

**Afrim Namani, drejtor i DKA-së**-tha se numri i nxënësve në ato dy profile është afër 48 nxënës. Ndërsa përsërit se nxënësit do të përfitojnë bursë pas aprovimit të rregullores.

Në vazhdimi kuvendit e hedhi në votim propozimin e Drejtorisë së Arsimit për ndarjen e subvencioneve për të cilën 18 anëtarë të kuvendit votuan “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim mjetet financiare të buxhetit të komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2020 në shumë të përgjithshme prej 292,914.00€, shpërndahen sipas pozicioneve të cekura si më poshtë:

#### 1.1 Zyra e Kryetarit:

1.1.1	Subvencione për Dekorata .....	2,914.00 €
1.1.2	Subvencione për raste të veçanta (sipas vlerësimit të Kryetarit të Komunës.....	50,000.00 €
	Gjithsej.....	52,914.00 €

#### 1.2 Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

1.2.1	Ndihmë për strehim – qiratë e banimit .....	20,000.00 €
1.2.2	Ndihmë për shërim.....	28,000.00 €
1.2.3	Ndihmë për familje skamnore.....	10,000.00 €
1.2.4	Financim të OJQ-ve.....	27,000.00 €
1.2.5	Bashkëfinancim me donatorë për familje të pastrehë.....	15,000.00 €
	Gjithsej.....	100,000.00 €

### 1.3 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:

1.3.1	Botimi i Librave - publikimeve .....	5,000.00 €
1.3.2	Financimi i OJQ-ve.....	75,000.00 €
1.3.3	Teatri i qytetit.....	10,000.00 €
	Gjithsej.....	90,000.00 €

### 1.4 Drejtoria për Arsim

1.4.1	Bursa për studentë.....	22,000.00 €
1.4.2	Transport për fëmijë me nevoja të veçanta.....	18,000.00 €
1.4.3	Bursa për nxënës të klasës së X-të, drejtimi- saldues dhe përpunues i drurit në SHMT “Lutfi Musiqi”.....	5,760.00 €
1.4.4	Shpërblime për nxënës.....	4,240.00 €
	Gjithsej.....	50,000.00 €

2. Vlera totale e subvencioneve të shpërndara sipas pozicioneve të lartëcekura është (292,914.00 €.) dyqind e nëntëdhjetë e dymijë e nëntëqind e katërbëdhjetë euro.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Arsim dhe Zyra e Kryetarit të komunës.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shtyrjen e afatit të pagesës së kështit për lejet ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet shtyrja e afatit të pagesës së kështit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë.

2. Afati për shtyrjen e pagesës së kështit bëhet për tre (3) muaj nga dita e arritjes së obligimit për pagesë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



8. Të ndryshme.

**a). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:**

**Ilmi Azemi, anëtarë i kuvendit**-adresi shqetësimin e qytetarëve që Bashkësia Islame nuk po e merr për bazë në tersi procedurën e ceremonisë fetare siç është hapja e varrit, ashtu siç është paraparë me vendimin e vitit 2018, andaj pyeti kryetarin e komunës se si qëndron situata me këtë çështje.

Mbledhja përfundoi në ora 16:40.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit